

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

5.12.2024

Ora 11:42

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i kërkesës nr. 4, datë 15.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative, referuar vendimit nr. 187, datë 08.10.2024 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. I. Rusmali (mungon), z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Dumi z. E. Mema, z. K. Puleri
- **Parti Politike:** (Sipas listës bashkëlidhur procesverbalit)
- **Të tjerë:** KRIIK  
Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo

*Z. E. Çefa:* Mirëdita të gjithëve! Atëherë deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 4, të datës 15 nëntor 2024, me objekt kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, ndaj znj. Haide Dhuli, me detyrë drejtore e shkollës së mesme të bashkuar “Qazim Pali” Borsh, ndaj të cilës Komisioneri i propozon KAS-it vendosjen e gjobës në masën 4 000 lekë dhe ndaj z.Vangjel Tavo, në cilësinë e kandidatit për kryetar i Bashkisë Himarë, ndaj të cilit Komisioneri i propozon KAS-it vendosjen e gjobës prej 100 000 lekë. Nga shorti i hedhur, pak ditë më përpara në ambientet e KQZ-së kam caktuar unë, anëtari Elvis

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Çefa, relator i çëshjes. Fillimisht po verifikojmë prezencën, është prezent trupa e KAS-it, në përbërje fizike prej tre anëtarësh, kjo nuk e pengon këtë të ketë kuorumin e nevojshëm për të vijuar këtë procedim administrativ. Ndërkohë që kolegu Bele për pak minuta do të na bashkohet, ndërsa kolegu Rusmali për arsye të justifikuara nuk është prezent në këtë seancë. Është prezent përfaqësuesja e e KQZ-së, ju lutem me mikrofon.

**Znj. J. Dumi:** Juneta Dumi.

**Z. E. Çefa:** Është prezent zonja? Ju lutem me mikrofon. Ndizeni ju lutem mikrofonin.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Avokate Mariola Ndina, përfaqësuese e shtetasit Vangjel Tavo.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Autorizimin ose prokurën mund ta depozitoni.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Me prokurë të posaçme, me repertori nr.4068, nr. koleksioni 1049, datë 16.12. 2024.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Mund ta depozitoni këtu. Për drejtoreshën, znj. Haide Dhuli ka përfaqësues? Nuk ka përfaqësues. Ajo ka dijeni rregullisht.

**Znj. J. Dumi:** Janë njoftuar rregullisht.

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*


**Z. E. Çefa:** Faleminderit! personat e interesuar në këtë procedim administrativ nga KRIIK, i cili ka bërë dhe denoncimin në Komisioner? Nuk kemi, proceduralisht prezencë, dakord. Atëherë mund të vijojmë, përpara ju lutem përfaqësueses së z. Tavo jeni dakord me trupën e KAS-it? Keni ndonjë kërkesë paraprake lidhur me përbërjen.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Jo i nderuar nuk kemi kërkesë, jemi dakord.

**Z. E. Çefa:** Dakord, ju faleminderit! Mund të vijojmë. Atëherë fjalën po ia jap përfaqësuese së KQZ-së. Shkurtimisht na parashtroni rrethanat e fakteve.

**Znj. J. Dumi:** Faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë denoncimin e regjistruar me nr. 2 ID, nga Koalicioni për Reformë dhe Integrim për Institucione të Konsoliduara, të datës 2.08.2024. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri nëpërmjet vendimit 137, datë 8.10.2024, për shqyrtimin administrativ, të denoncimit nr.2 nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024 ka konstatuar shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga disa subjekte. Në vijim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet kërkesës nr.4, datë 15.11.2024 i ka propozuar KAS-it vendosjen e masave administrative sipas shkeljeve përkatëse për subjektet referuar vendimit të sipër cituar.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Shkurtimisht do të doja pak a shumë, në qoftë se është e mundur për themelin, pak rrethanat e ngjarjes. Pse ka arritur Komisioneri në këtë konkluzion? Çfarë pretendohet që është, ku konsiston shkelja sipas Komisionerit?

**Znj. J. Dumi:** Atëherë me datë 2.08.2024, në funksion të fushatës së tij elektorale z. Vangjel Tavo, kandidat i Partisë Socialiste, për kryetar të Bashkisë Himarë ka zhvilluar një takim elektoral në shkollën e mesme të bashkuar “Qazim Pali” Borsh, me përfaqësues të kësaj partie. Ky takim elektoral është postuar gjithashtu edhe në faqen e tij zyrtare në facebook. Për më tej Komisioni Qendor i Zgjedhjeve ka dërguar kërkesat për informacion dhe ka administruar përgjigjet e palëve. Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve provohet se veprimtaria me karakter elektoral është kryer në ambientet e jashtme të institucionit publik, konkretisht në ambientet rrethuese të shkollës së mesme të bashkuar “Qazim Pali” Borsh, të paaksesueshme nga publiku. Vërtetohet se në këto takime ka pasur deklarime elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie. Provohet gjithashtu se në favor të kandidatit për kryetar në Bashkinë Himarë, me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e shkollës së mesme Borsh “Qazim Pali” janë vendosur burime publike në mbështetje të fushatës së tij. Gjithashtu provohet se drejtori i shkollës së mesme “Qazim Pali”, znj. Haide Dhuli ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore. Në këto kushte bazuar në nenin 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, gjithashtu bazuar dhe në vendimin nr. 9, të Komisionit Rregullator, në nenin 3, pika 1, 3.c, është vërtetuar që ka shkelje dhe Komisioneri ka bërë propozimet për vendosjen e sanksioneve.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. E. Çefa:** Shumë e qartë, ju faleminderit! Nga kolegët pyetje? Nuk ka. Atëherë po ia jap fjalën përfaqësues së z. Tavo që shkurtimisht të parashtrijë prapësimet lidhur me gjetjet e Komisionerit dhe argumentet e tjera.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Po i nderuar, faleminderit! Të nderuar anëtarë, faktikisht në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme 4.08.2024 për kryetarin e Bashkisë Himarë, kandidati i Partisë Socialiste në datën 1.08.2024 ka organizuar një takim elektoral në oborrin e shkollës, në shkollën e mesme të bashkuar “Qazim Pali” Borsh. Sa i përket rastit konkret vlerësojmë se në raport me parashikimet e Kodit Zgjedhor, si dhe në raport me parashikimet e Kodit Civil, në rastin e burimeve të sistemit shkollor parauniversitar nuk gjendemi përpara përdorimit të këtyre burimeve, për arsye se siç edhe mund të konstatohet nga foto, aktiviteti nuk është zhvilluar brenda ambienteve, pra nuk janë përdorur klasat, zyra apo nuk është kaluar edhe dera e shkollës së mesme të bashkuar “Qazim Pali” Borsh. Specifikimi që ligjvënësi i ka dhënë burimit në parashikimet e nenit 2, pikës 2 të nenit 92, në harmoni si dhe me nenin 142 të Kodit Civil sanksionon qartë se burimi në rastin në fjalë është send i paluajtshëm, ndërtesa lidhur me tokën, e trupëzuar me të në mënyrë të qëndrueshme. Jo rastësisht ligjvënësi ka specifikuar këtë detaj për të vendosur kufi se ku fillon përdorimi i burimit duke filluar me burimin me ndërtesën dhe në rastin në fjalë përdorimin e ambienteve të ndërtesës të shkollës në rastin konkret, gjë që nuk ka ndodhur. Nga ana tjetër nëse i referohemi dhe nenit 93 të ligjit 10019 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” kemi një shpjegim tjetër të kuptimit se çfarë do të quhet përdorim i burimeve apo ndërtesave publike në harmoni me sqarime sa më lartpërmendur. Pra, konkretisht në këtë dispozitë parashikohet, flasim për përdorimin e këtyre burimeve lidhur me përdorimin e ambienteve të brendshme të institucionit dhe jo në një ambient të jashtëm apo përreth tij. Nga ana tjetër me

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

përdorim të burimeve njerëzore kuptojmë përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës. Duke qenë se për vitin 2023-2024 ishte përfunduar programi shkollor dhe ka qenë në kohën e pushimeve verore dhe pjesëmarrja e drejtorit të shkollës përpos axhendës politike dhe të z. Blendi Klosi për të gjitha këto raste ka bindjen politike pjesëmarrja në evenimente të drejta kushtetuese të cilat mbrohen nga Kushtetuta, pra në asnjë rast nuk jemi në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye ne i kërkojmë Komisionit mospranimin e propozimit. Për më tepër do të sqarojmë edhe diçka nga ana formale e aktit. Pra ky propozim vjen në formën e një vendimi që normalisht duhet të jetë projekt propozim, pra është në shkelje të formës të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe Kodi i Procedurës Administrative, për këto arsye ne i kërkojmë pushimin e hetimit për z. Vangjel Tavo.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Pyetje nga kolegët?

**Z. L. Braho:** Kisha një pyetje në lidhje me pretendimin në lidhje me pjesën që oborri i shkollës nuk është objekt i ligjit. Në qoftë se i referohemi nenit 142 të Kodit Civil thotë janë sende të paluajtshme edhe toka dhe oborri i shkollës në dijenin tuaj, në administrim të kujt është? Është në administrim të bashkisë apo administrim të shkollës?

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** I nderuar, në përgjigje të pyetjes suaj do t'ju sqaroja që duke qenë një njësi administrative shumë e vogël, ka vetëm një shesh publik. Pra në Borsh ndodhet vetëm ky shesh publik që është oborri i shkollës dhe në kuptim të nenit 142, po vërtet është toka dhe pjesë e sendit të paluajtshëm po toka mbi të cilën shtrihet ndërtesa, pra nuk bëhet fjalë për tokën përreth. Në interpretimin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

tonë nuk është pjesë e enteve publike, pra është i vetmi shesh publik në atë njësi administrative, nuk ka shesh tjetër publik në njesinë administrative Borsh. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Edhe një saktësim ju lutem, takimi është zhvilluar në datën 1 gusht 2024, pra apo jo? Pra nuk qenë zyrtarisht sezon shkollor?

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Jo ka qenë, e sqarova 2023-2024 kish përfunduar procesi mësimor që prej qershorit 2024, kështu që kjo ishte pushime verore, nuk kishte aktivitete as mësimore, as të tjera në këtë oborr, po flasim gjithmonë se nuk po flasim për ambientet e shkollës.

**Z. E. Çefa:** E kuptova. Një pyetje për administratën e KQZ-së, drejtoresha e shkollës ka qenë prezent në seancën me Komisionerin?

**Znj. J. Dumi:** Po ka qenë gjithashtu dhe ajo prezent.

**Z. E. Çefa:** Dakord, mirë.

**Znj. J. Dumi:** Më falni në seancën jo.

**Z. E. Çefa:** Në seancë me Komisionerin.

**Znj. J. Dumi:** Po, po, ndjesë, atëherë e korigjoj, jo nuk ka qenë prezente.

**Z. E. Çefa:** Nuk ka qenë prezente fare.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Znj. J. Dumi:** Ndjesë! Në fakt iu referova aktivitetit.

**Z. L. Braho:** Po në aktivitet del këtu në foto apo ka mbajtur ndonjë fjalim?

**Znj. J. Dumi:** Është e dukshme nga fotot.

**Z. L. Braho:** Ku është ajo?

**Znj. J. Dumi:** Në fakt dhe në denoncimin që është marrë nga KRIIK-u është shprehur që ajo ka qenë prezente njëkohësisht, por ka qenë prezent dhe z. Tavo, kanë qenë prezentë dhe politikanë të tjerë në zhvillimin e këtij takimi elektorale. Domethënë është e shprehur në mënyrë literale, por është njëkohësisht dhe në fotot në qoftë se shihet.

**Z. K. Bele:** Përshëndetje! Kam një pyetje, aktiviteti se u informova nga relatori, aktiviteti në çfarë ore është zhvilluar nëse e kemi këtë informacion? Në qoftë se e kemi si informacion, është pasdite, është ditë e shtunë, është ditë e diel? Meqë u përmend prezenca e drejtuesit të shkollës.

**Z. E. Çefa:** Mbase te kërkesa e KRIIK-ut.

**Znj. J. Dumi:** Po ka qenë data 8. Atë po shikoj, a është evidentuar ora.

**Z. E. Çefa:** Jo nuk ka orë. Përfaqësuesja e z. Tavo, a mund të na thoni të lutem, na ndihmoni pak sipas informacionit tuaj.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Unë nuk kam informacion, i nderuar, se kur është zhvilluar aktiviteti.

**Z. E. Çefa:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Si mendoni është zhvilluar në mëngjes apo pasdite aktiviteti?

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Unë e sqarova që ka qenë periudhë pushimesh vjetore, verore, shkolla nuk ka pasur aktivitet mësimor edhe stafi mësimor ka qenë me pushime sepse të gjithë e dimë që brenda një periudhe pas përfundimit të procesit mësimor vërtet është stafi mësimor, stafi pedagogjik atje, por më vonë marrin pushimet dhe ata. Kështu që është e drejtë e gjithsecilit të marrë pjesë në këto aktivitete, është një e drejtë kushtetuese, pavarësisht pozicioneve. Secili ka qenë në periudhë pushimesh, pavarësisht nga ora e caktuar. Ka qenë një gusht, kështu që të gjithë e dimë që ajo është periudhë pushimesh për të gjithë.

**Z. L. Braho:** Në qoftë se e keni informacionin, se ju e kuptoj jeni avokatja e z. Tavo, drejtoresha e shkollës në çfarë cilësie ka qenë? Ka qenë në cilësinë e qytetares?

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Po në cilësinë e qytetares, thjesht pjesëmarrëse ka qenë.

**Z. L. Braho:** Pra thjesht është rastësi që tek oborri i shkollës, që ajo është drejtoreshë.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Ka qenë pjesëmarrëse në aktivitet si çdo qytetar tjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. L. Braho:** E kuptoj, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Atëherë meqë s'ka pyetje të tjera mendoj që ta përmbyllim. Shkurtimisht me dy fjali konkluzionet. Duke filluar përkatësisht nga përfaqësuesja e Komisionerit.

**Znj. J. Dumi:** Atëherë ne i qëndrojmë vendimit të Komisionerit dhe kërkojmë gjobë për znj. Haide Dhuli, drejtore e shkollës së mesme të bashkuar "Qazim Pali" Borsh, në vlerën 4 000 lekë dhe për z. Vangjel Tavo, kandidat për bashkinë Himarë, në vlerën 100 000 lekë.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Pra ju kërkon pranimin e kërkesës në tërësinë e saj. Përfaqësuesja e z. Tavo? Shkurtimisht ju lutem.

**Znj. M. Ndina, përfaqësuese e z.V.Tavo:** Po i nderuar, në përfundim ne i kërkojmë anëtarëve të nderuar mospranimin e propozimit të Komisionerit dhe pushimin e hetimit administrativ për shtetasin z. Vangjel Tavo. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Mirë, ju faleminderit! Atëherë ne do ta ndërpresim seancën, do na duhet pak kohë të diskutojmë, po për shkak se kemi një seancë tjetër në vijim, ne rezervojmë të drejtën që vendimin ta shpallim munda, avokaten ju jeni e lirë ndërkohë. Nuk keni arsye të qëndroni dhe ta merrni vesh pastaj nëpërmjet njoftimit.

**Rifillon seanca**

**Ora 14:03**

**Z. E.Çefa:** Përshëndetje dhe njëherë! Riçelim seancën për shpalljen e vendimit të Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve për sa i përket shqyrtimit të kërkesës së

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 4, datë 15.11.2024. KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi duke qenë se kërkesa nuk mori numrin e votave të domosdoshme për t'u miratuar deklaroi rrëzimin e kërkesës nr. 4 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 15.11.2024. Me kaq këtë seancë e deklarohet të mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 45**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

5.12.2024

Ora 12:13

**RENDI I DITËS**


*Shqyrtimi i kërkesës nr. 3, datë 15.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative, referuar vendimit nr. 186, të KSHZ, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023” (vijon).*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Dumi, z. K. Puleri, z.E. Mema
- **Parti Politike:** (Sipas listës bashkëlidhur procesverbalit)
- **Të tjerë:** **KRIIK**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje, riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës nr. 3 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kërkesë që ka të bëjë me raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Seanca është seancë vijuese e seancës së datës 3 dhjetor 2024. Meqenëse janë shumë palë, nuk u arrit të mbyllej shqyrtimi administrativ me datën 3, kështu që sot do të vijojmë me pikat 78 e vijuese të kërkesës së Komisionerit, që vijojnë me kërkesën për sanksion administrativ me gjobë për një sërë kandidatësh për kryetar bashkie për zgjedhjet e 14 majit si dhe me propozimet për masa për disa parti politike. Kështu që e pranishme është administrata e KQZ-së, trupa e plotë e KAS-it dhe sipas rastit

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

do të shohim në qoftë se ka të pranishëm palë të interesuara për të cilat propozohen sanksione administrative me gjobë. Atëherë fillojmë me z. Shefki Çota, i cili ka qenë kandidat i “Partisë së Lirisë” për Bashkinë Librazhd, për të cilin është propozuar gjobë në vlerën 118 000 lekë bazuar në nenin 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Z. Çota është i pranishëm? Jo, përfaqësues nuk ka. Dakord. Vijojejmë me KQZ-në, cili është argumenti për propozimin e këtij sanksioni administrativ?

**Z. K. Puleri:** Te ky sanksion vazhdojmë me argumentin se kandidati ka pranuar fonde “cash” në vlerën 118 000 lekësh dhe këto fonde nuk i ka kaluar nëpërmjet llogarisë së posaçme.

**Z. L. Braho:** Fondet janë deklaruar si fonde të vetat apo si?

**Z. K. Puleri:** Si fonde të vetat, është i njëjtë me rastet që kemi shqyrtuar më përpara.

**Z. L. Braho:** Dakord. Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Jo. Vazhdojmë me z. Shkëlqim Hoxha, kandidat i “Partisë së Lirisë” gjithashtu, për Bashkinë Rrogozhinë, për të cilin propozohet gjobë në vlerën 300 016 lekë. Z. Hoxha nuk është i pranishëm, as përfaqësues nuk duket, kështu që ia japim fjalën përfaqësuesit të KQZ-së.

**Z. K. Puleri:** Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me pranimin e fondeve jo nëpërmjet llogarisë së posaçme por fonde të cilat kanë kaluar “cash” dhe janë fonde të vetë kandidatit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. L. Braho:** Z. Zija Ismaili, kandidat i “Partisë së Lirisë” për Bashkinë Berat 105 840 lekë është gjoba që propozohet. Z. Zija Ismaili nuk është i pranishëm, as përfaqësues nuk ka, kështu që vijojmë me KQZ-në.

**Z. K. Puleri:** Edhe me këtë rast për kandidatin kemi të bëjmë me të njëjtën shkelje, pra pranim të fondeve në vlerën 105 840, jo nëpërmjet llogarisë së posaçme por “cash”.

**Z. L. Braho:** Dhe i fundit për këtë lloj sanksioni është z. Zihni Pollozhina, kandidat për Bashkinë Pogradec, i “Partisë së Lirisë”, 188 000 lekë, propozimi për sanksion me gjobë. Në të njëjtat kushte jemi? Z. Zihni Pollozhina nuk është i pranishëm, as përfaqësues nuk ka. Jemi në të njëjtat kushte?

**Z. K. Puleri:** Po jemi në të njëjtat kushte, për pranimin e fondeve “cash”, jo nëpërmjet llogarisë së posaçme.

**Z. L. Braho:** Dakord, mirë. Vijojmë me pikën 83 që është propozimi për sanksion me gjobë për z. Pjerin Ndreu, kandidat për Bashkinë Lezhë, i Partisë Socialiste, për të cilin është propozuar gjobë në vlerën 720 000 lekë sipas nenit 173, pika 6 e Kodit Zgjedhor. Atëherë na argumentoni pak këtë rast. Z. Ndreu nuk është i pranishëm. Përfaqësues ka? Jo nuk ka.

**Z. K. Puleri:** Në këtë rast kemi të bëjmë me një sanksion i cili parashikohet në nenin 173, pika 6, pasi kandidati për kryetar bashkie, z. Pjerin Ndreu ka pranuar fonde nga donatorë të cilët janë të ndaluar. Këta donatorë janë, donatori në fjalë ka përfituar fonde publike, ka marrë pjesë në garë publike, pra ka qenë përfitues i tenderave dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

si rrjedhojë nuk lejohet që ky të japë ndihmë në fushatë ose të jetë donator në fushatë dhe shuma e cila përkon me shumën prej 720 000 lekësh. Është një shumë e cila duhet t'i kthehet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. L. Braho:** Mund t'i shqyrtojmë pak këto provat, në bazë të të cilave është propozuar ky sanksion administrativ. Nga e para, kjo shumë është derdhur në llogarinë e posaçme.

**Z. K. Puleri:** Po kjo ka kaluar nëpërmjet llogarisë së posaçme, për provat do më duhet pak kohë, pasi të marr shkresën që i është dërguar Autoritetit Publik të Prokurimit, të cilit ne i jemi drejtuar për të marrë informacion në lidhje me, nëse subjekti që ka bërë dhurimin ka qenë përfitues i tenderave. Gjithashtu këto shkresa mund t'ju vëmë në dispozicion për të vërtetuar pjesën e donacionit që është bërë.

**Z. I. Rusmali:** E keni verifikuar nëse përfitimin e tenderave e ka pasur nga kjo njësi administrative, nga Bashkia?

**Z. K. Puleri:** Në këtë rast bëhet fjalë për një shoqëri sigurimi, në të cilën dhe vetë z. Ndreu është aksioner dhe kjo ka përfituar fonde publike në një institucion publik, pra ka qenë përfituese e fondeve publike.

**Z. I. Rusmali:** Në rregullat që keni ju në fuqi bëhet ky dallim apo nuk bëhet? Dallimi subjekti elektoral përfiton fonde, përfiton financim nga një subjekt privat i cili është përfitues fondesh publike, bëhet dallimi, në gjithë territorin, në njësinë përkatëse ku zhvillohen zgjedhjet për subjektin elektoral? Bëhet ky dallim apo nuk ka nevojë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. K. Puleri:** Ky dallim është i përgjithshëm nuk është i kanalizuar pra që duhet vetëm në këtë bashki.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Vetëm se do na i paraqisni pak këto provat në lidhje me këtë rast. Mirë kalojmë te pika 84 që tashmë ka të bëjë me sanksione që propozohen për partitë politike. Atëherë për partinë “Partia Socialiste e Shqipërisë” gjobë me vlerën 300 000 lekë sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor. E pranishme është përfaqësuesja e posaçme e Partisë Socialiste. Atëherë për KQZ-në njëherë kush është baza ligjore për, ose më saktë cilat janë argumentet për këtë lloj sanksioni administrativ.

**Z. K. Puleri:** Në këtë pikë kemi të bëjmë me, KQZ-ja i është drejtuar me një shkresë për informacion Partisë Socialiste në lidhje me shpenzimet për reklamat politike dhe nuk ka marrë një përgjigje në kohën duhur për këtë informacion të kërkuar dhe si pasojë është vendosur sanksion për mosbashkëpunim dhe vonesa në kthim përgjigje ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. L. Braho:** Një pyetje, është përsëritëse Partia Socialiste në lidhje me këtë shkelje, në dijeninë që keni ju apo është hera e parë që shkel?

**Z. K. Puleri:** Në dijeninë time nuk është përsëritëse për mosbashkëpunim.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Fjala për përfaqësuesen e Partisë Socialiste.

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Faleminderit z.kryetar i seancës. Bashkëlidhur keni dhe autorizimin ku unë jam përfaqësuese e përhershme pranë KQZ-së e Partisë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Socialiste. Atëherë siç u relatua, Partia Socialiste është gjobitur në vlerën 300 000 lekë për mungesë bashkëpunimi. Rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka dërguar shkresën nr.1435 protokolli, në datë 29.05.2024 subjektit politik dhe ndërkohë ka vijuar monitorimin apo hartimin e raportit të saj lidhur me audituesin ka nxjerrë si rezultate nga auditimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore. Ka rezultuar se të njëjtën shkelje, se shkresën lidhur me informacionin që kërkohet nga Partia Socialiste i është bërë dhe ofruesit të shërbimit mediatik audioz-viziv, pasi për këto ishte problemetika, rezulton disa minutazhe më tepër dhe këtë përgjigje e kanë marr dhe nga ofruesit e shërbimit mediatik. Pra rezulton se në thelb, në vetvete, atë informacion që kanë dashur ta marrin nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në fakt e kanë siguruar dhe nga pala tjetër dhe pavarësisht kësaj, pavarësisht faktit se Partia Socialiste nuk është se ka qenë përsëritëse në këtë, në bashkëpunim me KQZ-në, pavarësisht faktit se raportet janë dorëzuar, raportet financiare janë dorëzuar gjithmonë në kohë, i ka qëndruar korrekt zbatimit të ligjit apo zbatimit të dispozitave siç i kërkojnë pikërisht me detyrimet që i takojnë fushatës zgjedhore, KQZ-ja ka vendosur që, ose Komisioneri ka vendosur të propozojë masën 300 000 lekë duke mos mbajtur, në fakt në raport të drejtë apo proporcional, që është parim kushtetues i rëndësishëm midis shkeljes që pretendohet dhe marzhit të dënimit që ka vendosur të propozojë. Vetë dispozita përcakton një marzh dënimi nga 100 000 deri 3 000 000 lekë dhe konstaton se për të njëjtat shkelje ka dhe Partia Demokratike, ka propozuar masën 200 000 lekë dhe për të njëjtën shkelje propozon masën 300 000 lekë për Partinë Socialiste që nuk e di se ku qëndron diferenca dhe vendos masa të ndryshme. Është e qartë që në vendimmarrjes trupat nuk duhet të udhëhiqen nga parimi i ndëshkimit por vetëm nga parimi i edukimit dhe nga parimi i ndërgjegjësimit për zbatimin e ligjit dhe në këtë rast unë shikoj që mungon një raport i drejtë midis shkeljes së pretenduar dhe masës së vendimit të propozuar nga Komisioneri. Kjo

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 5.12.2024*

është në themel edhe sa i takon në fakt edhe ligjit të Kodit të Procedurave Administrative nga i cili udhëhiqet edhe puna juaj është përsëri i njëjti parim, raporti i drejtë midis shkeljes dhe dënimit dhe mendoj se në këtë rast nuk është respektuar. Unë i kam dhe me shkrim pretendimet, dua të theksoj që Partia Socialiste në fakt nuk është përgjigjur, këtë nuk mund ta mohojmë por ka qenë thjesht një ekuivok sepse kanë menduar që dikush ka kthyer përgjigje, përgjigja nuk ka ardhur dhe në momentin që është njohur me projektraportin e ka dërguar përgjigjen duke sqaruar rrethanat për të cilat ishin ngritur pyetjet në shkresë, pra në datë 16.09.2024 është njohur me projektraportin e pretendimin lidhur me mungesën e përgjigjes dhe menjëherë ka dërguar shkresën që në fakt mendonin që e kishin çuar në kohën e duhur. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dakord. Faleminderi! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

**Z. I. Rusmali:** Po, për administratën e KQZ-së, përfaqësuesja e subjektit thotë ka diferencë trajtimi midis subjektit që ajo përfaqëson dhe një subjekti tjetër këtu. Ju e keni parë këtë diferencë trajtimi dhe në qoftë se edhe ju e konstatoni këtë diferencë keni motive për diferencimin?

**Z. K. Puleri:** Motivet në lidhje me diferencimin vijnë për arsye se kur është bërë kërkesa për shpenzime reklama politike, krahas, në qoftë se këto shpenzime politike ne i përkthejmë në vlerë monetare ka qenë më e madhe vlera e diferencës që ne po kërkojmë informacion te Partia Socialiste se sa te Partia Demokratike apo te partitë vijuese.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. K. Bele:** E kuptojmë, kisha vetëm një pyetje, ju i keni dërguar një letër nëse e kuptova drejt në datë 29 i katërti?

**Z. K. Puleri:** 29 i pesti.

**Z. K. Bele:** Raporti ishte hartuar? Ju përmendët një datë po s'e fiksova. Ka pasur ndonjë rikujtesë apo ndonjë gjë tjetër që, pra veç mospërgjigjes së shkresës ka pasur, duke pasur parasysh që me subjektet ka një linjë komunikimi, sidomos këto subjekte që kanë përfaqësues në KQZ. Pra keni ndonjë dokumentim që të krijojmë bindjen për refuzimin e bashkëpunimit apo është vetëm kjo shkresë pa përgjigje, këtë desha të kuptoj, pra që është njoftuar KQZ-ja për të konkluduar në moskthimin e përgjigjes së kësaj shkresës për ta konsideruar refuzimin të kryer?

**Z. K. Puleri:** Në lidhje me këtë rast nuk ka pasur një komunikim të dytë shkresor, pas shkresës së dërguar nga ana jonë por ka pasur komunikim nëpërmjet telefonit, këtë rikujtesë.

**Z. K. Bele:** Ju kanë thënë që e keni marrë në telefon apo keni ndonjë të dhënë aty apo diçka?

**Z. K. Puleri:** Jam pjesë e sektorit i cili merret me këtë pjesë.

**Z. I. Rusmali:** Pra meqë jemi këtu, si sillet subjekti zakonisht në komunikimin me ju, është bashkëpunues zakonisht apo është zakonisht neglizhent?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. K. Puleri:** Jo zakonisht subjekti ka qenë shumë korrekt në kthimin e përgjigjeve që kemi pasur ose dhe komunikimet me sektorin dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, prandaj ju thashë dhe më përpara që nuk është një rast i ripërsëritur, është rasti i parë që ka ndodhur në moskthimin e përgjigjes.

**Z. I. Rusmali:** Subjekti pretendon këtu që mungesa e kësaj përgjigje specifike nuk ka sjellë asnjë dëm për procesin e hetimit administrativ sepse në fakt përgjigjen e keni marrë nga burime të tjera. Është e vërtetë kjo?

**Z. K. Puleri:** Përgjigja është marrë nga burime të tjera po ne bëjmë një kryqëzim të të dhënave, pra pasi marrim dhe përgjigje nga AMA, marrim dhe përgjigje nga subjekti, shikojmë dhe auditimin, gjetjet nga audituesja e kontraktuar dhe ne na nevojiten këto informacione për të bërë një kryqëzim dhe të dhëna për të dalë në një përfundim dhe kjo normal që sjell vonesa në procesin përfundimtar.

**Z. I. Rusmali:** Dhe bën të pamundur verifikimin e informacionit nga burime të tjera janë të besueshme apo jo? Pra mungesa e kryqëzimit, kryqëzimi i të dhënave është element i rëndësishëm i kontrollit financiar dhe mungesa e këtij kryqëzimi ju sjell këtë dëm. Dakord.

**Z. L. Braho:** Po.

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Nga pyetja që bëri anëtari i trupit, më lindi dhe mua një pyetje. Atëherë thatë që keni kontaktuar në telefon për të rikujtuar shkresën, e keni marrë, e keni kërkuar këtë informacion në telefon sepse si arriti që doli në një përfundim raporti, domethënë ju keni dalë në një përfundim lidhur me pretendimin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

që keni ngritur, nëse ka qenë e pamundur kryqëzimi i të dhënave etj., etj., në telefon e keni kërkuar këtë informacion?

**Z. K. Puleri:** Në telefon është kërkuar informacion për kthim përgjigje për shkresën e dërguar në datën 29.05, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. I. Rusmali:** Të dhënë, informacionin e keni marrë nëpërmjet telefonit apo jo?

**Z. K. Puleri:** Ky informacion nuk mund të merret dot nëpërmjet telefonit se është një informacion, i cili është voluminoz dhe do një përgjigje me shkresë sepse janë disa televizione, pra nuk mund të flasim dot në telefon në lidhje me shumatat e kërkuara nga ana jonë.

**Z. L. Braho:** Plus që nuk përbën provë besoj përgjigja me telefon?

**Z. K. Puleri:** Po telefoni nuk përbën provë.

**Z. L. Braho:** Dakord, besoj se ishte shterues debati në lidhje me këtë, duke iu referuar dhe faktit që besoj se janë marrë parasysh kur është propozuar gjoba 300 000 lekë, se maksimumi është 3 000 000 lekë. Dakord, vijojmë me Partinë Demokratike, e cila po ashtu ka një propozim për sanksion në vlerën 200 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 e Kodit Zgjedhor. I pranishëm është z. Franci Nuri, si fillim për KQZ-në fjalën në lidhje me arsyet e propozimit të këtij sanksioni administrativ.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Po, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. K. Puleri:** Edhe në këtë rast kemi të bëjmë, është i njëjti rast si me rastin e shqyrtuar pak më përpara, kemi të bëjmë me dërgim shkresë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kërkim informacioni ndaj subjektit dhe subjekti nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. L. Braho:** Dakord, z. Nuri.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD::** Faleminderit! Po e filloj me një pyetje për administratën e KQZ-së, kur është kërkuar, ma kujtoni dhe njëherë ju lutem kur është kërkuar informacioni, në ç' datë dhe a keni dërguar ndonjë kërkesë të përsëritur?

**Z. K. Puleri:** Atëherë informacioni i është dërguar subjektit zgjedhor, Partia Demokratike, është dërguar në datën 29.05.2024.

**Z. F. Nuri:** Nga ai moment nuk keni kërkuar përsëri një informacion dhe s'keni marrë asnjë informacion nga Partia Demokratike lidhur me këtë?

**Z. K. Puleri:** Jo asnjë lloj përgjigje.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** E keni dërguar me postë apo me email sepse ne zakonisht si subjekt politik njoftohemi edhe nga personeli, stafi i selisë që merr njoftimet, na njofton menjëherë kur ka diçka nga KQZ-ja.

**Z. K. Puleri:** Është dërguar me anë të postës kjo shkresë te subjekti.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Me lajmërim-marrje, pra jeni të sigurtë që letra ka shkuar?

**Z. K. Puleri:** Po ka shkuar sepse nuk kemi pasur kthim zarfi për këtë rast.

**Z. F. Nuri, përfaqësues PD:** Po emri i personit që e ka marrë se më bën thjesht habi, zakonisht ne na njoftojnë menjëherë. Jo nuk e vë në dyshim duhet të jetë te selia.

**Z. K. Puleri:** Adresa është bulevardi “Zhan D’Ark”, nr.11, Tiranë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Emrin e personit që ka nënshkruar për shembull mund të na e relatoni.

**Z. K. Puleri:** Këtë informacion për momentin nuk e kam sepse pas...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jo thjesht desha të sigurohem që letra ka shkuar sepse zakonisht ne na njofton KQZ-ja shpesh edhe me email, kemi marrë emaile dhe në 12 të natës, jemi të informuar.

**Z. K. Puleri:** ...dërgimit të shkresave bëjnë dhe lajmërimin e marrjes, në momentin që nuk merr përgjigje nga subjekti, zarfi i kthehet përsëri Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ne administrojmë këtë që mund ta paraqesim si provë, në këtë rast nuk e kemi zarfin, pra supozojmë që është kryer, ka vajtur.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** E kuptoj. Unë gjykoj se Partia Demokratike bashkëpunon mjaft mirë me KQZ-në në përgjithësi, nuk e di në rastin konkret, ndoshta zarfi nuk ka shkuar fare dhe nuk na është komunikuar sepse nuk gjej shpjegim tjetër.

**Z. L. Braho:** Mbase duhet bërë një verifikim nga KQZ-ja se me çfarë adrese ishte regjistruar Partia Demokratike në zgjedhjet e 14 majit 2023, se mos ndoshta adresa ka qenë në vend tjetër dhe zarfi është dërguar në vend tjetër, duke iu referuar dhe problematikës në atë kohë, kështu që do të shohësh pak dokumentat kur është bërë regjistrimi i Partisë Demokratike në ato zgjedhje që të shohim edhe këtë pjesë. Dakord. Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Jo. Viojmë me “Partinë Agrare Ambjentaliste të Shqipërisë”, ka përfaqësues? Jo nuk ka. Për këtë parti është propozuar në bazë të nenit 173, pika 8, gjobë në vlerën 100 000 lekë.

**Z. K. Puleri:** Kemi të bëjmë me të njëjtin rast të dërguar shkresë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në lidhje me kërkesën për informacion për shpenzime, për reklama politike dhe nuk është kthyer një përgjigje nga subjekti për kërkesën e kryer nga ana jonë.

**Z. L. Braho:** Dakord, po ashtu për Partinë Republikane 173 000 lekë. Ka përfaqësues? 100 000 lekë, në bazë të nenit 173, pika 8, njësoj është dhe kjo?

**Z. K. Puleri:** Po është e njëjta masë, e njëjta rrugë, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dërguar kërkesë për informacion dhe nuk kemi marrë një përgjigje për kërkesën e bërë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

**Z. L. Braho:** Dakord. E fundit është “Partia Konservatore” që po ashtu në bazë të nenit 173, pika 8 është propozuar për gjobë.

**Z. K. Puleri:** Po është i njëjti rast si më përpara.

**Z. L. Braho:** Mirë, dakord. Mirë atëherë, trupa e KAS-it do të tërhiqet për të shpallur vendimin në lidhje me kërkesën nr. 3 të Komisionerit që ka të bëjë me vendimin 186, projektpropozimi për sanksione. Seanca do të rifillojë për shpalljen e vendimit në ora 13.45. E deklarojmë të mbyllur seancën.

**Rifillon seanca**

**Ora 13:53**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje dhe njëherë! Riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës të Komisionerit nr. 3, propozim për vendosje sanksioni administrativ. KAS pasi u tërhoq për vendim, si përfundim vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës nr. 3 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si më poshtë vijon:

Vendosjen e masës administrative me gjobë për “Partinë Aleanca e Maqedonasve për Integrim European” në vlerën 500 000 lekë sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e masës administrative me gjobë në masën 500 000 lekë për “Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.

Vendosjen e masës administrative me gjobë për partinë politike “Partia Aleanca Liberale e Djathtë” në vlerën 500 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e gjobës në vlerën 500 000 lekë për “Partinë Aleanca Arbnore Kombëtare” .

Rrëzimin e kërkesës për vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 500 000 lekë për “Partinë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”.

Pranimin e kërkesës për vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 500 000 lekë për “Partinë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”.

Pranimin e kërkesës për vendosjen e masës administrative me gjobë për “Partinë Aleanca Progresiste” LZHK, në vlerën 500 000 lekë

Pranimin e kërkesës për vendosjen e masës administrative për Partia Ardhmëria Shqiptare me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Bindja Demokratike” me gjobë në vlerën 500 000 lekë

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë Partia Fronti i Majtë, me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Fryma e Re Demokratike” me gjobë në vlerën 500 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative me gjobë për partinë “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për “Partinë Lidhja Demokristiane Shqiptare” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për “Partinë Nisma Thurje”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Agrare Ambjentaliste” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Balli Kombëtar” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Demokracia Sociale” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Demokratike” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia e Gjelbër” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Emigracioni Shqiptar” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative me gjobë për partinë “Partia Komuniste e Shqipërisë” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Konservatore” me gjobë në masën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Kristian Demokrate” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia për të Drejtat e Puntorve të Shqipërisë” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Republikane Shqiptare” me gjobë në vlerën 500 000 lekë.

Rrezimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Uniteti Kombëtar” me gjobë me vlerën 500 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigranteve” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Arbnore Kombëtare” me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorve të Shqipërisë” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Komuniste e Shqipërisë” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Uniteti Kombëtar” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Konservatore” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë “Partia Reforma Demokratike Shqiptare” me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Në lidhje me kandidatët me propozimin për masë administrative me gjobë për kandidatët Arif Tafani, Armando Subashi, Emirjana Sako, Kreshnik Hajdari, Majlinda Bufi, Mariglen Disha, Agron Malaj, Bukurosh Maçi, Agron Loka, Albert Mëlyshi, Ardit Cikuli, Arjan Hoxha, Aurel Malko, Bardh Spahija, Bedri Hoxha, Behar Haxhiu, Besnik Dushaj, Dëfrim Fiku, Dorjan Lani, Edmond Komino, Elvis Hajdërlli, Ethem Lumani, Evdar Kodheli, Fatmir Shero, Fisnik Qosja, Hasim Çekrezi, Hilë Curri, Hysni Sharra, Igli Cara, Ismail Uka, Lefter Maliqi, Luçiano Boçi, Miftar Dauti, Pashk Gjoni, Resmi Shanaj, Shefki Çota, Shkëlqim Hoxha, Sofije Alushaj, Zija Ismaili dhe Zini Tollozhina, KAS vendos kthimin e kërkesës për hetime të mëtejshme në lidhje me propozimet për këta kandidatë. Natyrisht që të bëhet një verifikim më i thelluar në lidhje me pjesën e fondeve të deklaruara si të përfshira në buxhetin për fushatë nga fondet personale të kandidatëve. Në mënyrë më të detajuar detyrat do të caktohen në vendimin e arsyetuar.

KAS po ashtu pranon kërkesën për marrjen e masës administrative për kandidatin për kryetar bashkie z. Pjerin Ndreu me gjobë në vlerën 720 000 lekë. Vendos të pranojë pjesërisht kërkesën e Komisionerit në lidhje me propozimin për marrje sanksioni për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe vendosjen e gjobës në vlerën 100 000 lekë.


Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Demokratike” me gjobë në vlerën 200 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë, “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 100 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia Republikane” me gjobë në vlerën 100 000 lekë.

Pranimin e kërkesës për marrjen e masës administrative për partinë politike për “Partia Konservatore” me gjobë në vlerën 100 000 lekë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.12.2024*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi. U shpall sot me datë 5.12.2024. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 44**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

